



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 tetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Arsyeve
të Pranimi të Provave të W03780-ës dhe Urdhrit Lidhur me To (F02580)**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup
Krasniqit**
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 28 dhe 29 gusht 2024, W03780 ("dëshmitari") dha dëshmi në këtë çështje gjyqësore.¹
2. Më 29 gusht 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti për pranim si prova materiale tri deklarata të dëshmitarit ("deklaratat"),² dhe ekipet e mbrojtjes së katër të akuzuarve ("Mbrojtja") bënë parashtime gojore për kundërshtimin e pranimin të deklaratave.³
3. Më të njëjtën ditë, Trupi Gjykses pranoi deklaratat me numrat e provave P01581 ("deklarata e vitit 2010"), P01582 ("deklarata e vitit 2006"), dhe P01583 ("deklarata e vitit 2018"), dhe bëri me dije se më pas do t'i paraqiste me shkrim arsyet e këtij vendimi.⁴
4. Më 17 shtator 2024, Trupi Gjykses paraqiti arsyet e pranimin të deklaratave ("Vendimi i Kundërshtuar").⁵
5. Më 25 shtator 2024, Mbrojtja dorëzoi kërkesë të përbashkët për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").⁶

¹ Transkripti i Seancave, 28-29 gusht 2024, konfidencial.

² Transkripti i Seancës, 29 gusht 2024, f. 19297-19299, 19303-19307, konfidencial.

³ Transkripti i Seancës, 29 gusht 2024, f. 19299-19303, 19307-19308, konfidencial.

⁴ Transkripti i Seancës, 29 gusht 2024, f. 19308-19309, konfidencial.

⁵ F02580, Trupi Gjykses, *Arsyet për Pranimin e Deklaratave të W03780-s dhe Urdhër Lidhur me To*, 17 shtator 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F02580/RED).

⁶ F02597, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë për Leje për Apelimin e Arsyeve për Pranimin e Deklaratës së W03780-s dhe Urdhrit Lidhur me To (F02580)*, 25 shtator 2024, konfidenciale.

6. Më 7 tetor 2024, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigja").⁷
7. Mbrojtja bëri me dije se nuk do t'i kundërpërgjigjej Përgjigjes.⁸

II. PARASHTRIMET

8. Mbrojtja kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me tri pikat e mëposhtme:

1. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim ligjor duke arritur në përfundimin se deklarata e vitit 2006 përbënte deklaratë me shkrim në kuptimin e rregullës 143(2) ("Pika e Parë");
2. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik apo ligjor kur nuk vlerësoi efektin dëmtues të pranimin të deklaratës së vitit 2006 kundrejt vlerës së saj provuese, siç e kërkon rregulla 138 ("Pika e Dytë"); dhe
3. Nëse deklarata e vitit 2018 mund të pranohet si provë në pajtim me rregullën 143(2) duke pasur parasysh se u përdor vetëm për t'i freskuar kujtesën dëshmitarit ("Pika e Tretë").⁹

9. Mbrojtja parashtrohet se pikat e paraqitura i plotësojnë kushtet për miratimin e lejes pasi: (i) ato burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe janë aspekte të konkrete dhe të identifikueshme ligjore dhe jo thjesht mospajtime;¹⁰ (ii) ndikojnë në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit;¹¹ dhe (iii) një vendim i menjëhershëm për to i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.¹²

10. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi tri pikat nuk arrijnë të përmbushin kushtet për leje sipas nenit 45 dhe rregullës 77.¹³ ZPS-ja parashtrohet se Mbrojtja: (i) nuk ka treguar se çfarë ndikimi, e aq më pak ndikimi të ndjeshëm,

⁷ F02617, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Leje për Apelimin e Arsyeve për Pranimin e Deklaratës së W03780-s dhe Urdhrit Lidhur me To (F02580)*, 7 tetor 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F02617/RED).

⁸ *Shih* Korrespondencën 624.

⁹ Kërkesa, para. 2, 25.

¹⁰ Kërkesa, para. 6, 11, 17, 21.

¹¹ Kërkesa, para. 6, 12-13, 18-19, 22-23.

¹² Kërkesa, para. 6, 14, 20, 24.

¹³ Përgjigja, para. 1, 7-8, 10.

do të mund të kishte shqyrtimi në apel lidhur me ecurinë apo rezultatin e gjykitimit;¹⁴ dhe (ii) nuk ka treguar se si do të mund të kontribuonte thelbësisht në procesin gjyqësor një vendim i menjëhershëm i Gjykatës së Apelit.¹⁵ Sipas ZPS-së, Kërkesa: (i) përpiqet të rishqyrtojë pranimin si prova të deklaratës së vitit 2016 dhe të deklaratës së vitit 2018; (ii) shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar; (iii) shtrembëron kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara ("DHS"); dhe (iv) shtrembëron provat.¹⁶ Në fund, ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses i ka interpretuar në mënyrë të drejtë rregullat 138(1) dhe 143(2)(c),¹⁷ dhe se Mbrojtja thjesht nuk pajtohet në Vendimin e Kundërshtuar.¹⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi për miratimin e lejes për apel i përcaktuar në këto dispozita. Në rregullën 77(2) parashikohet se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykitimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

12. Trupi Gjykses përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse mbi standardin ligjor për marrjen e lejes për apel, të përcaktuar në vendimet e kaluara.¹⁹

¹⁴ Përgjigjja, para. 7.

¹⁵ Përgjigjja, para. 8.

¹⁶ Përgjigjja, para. 3.

¹⁷ Përgjigjja, para. 7.

¹⁸ Përgjigjja, para. 3. *Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 4-5.*

¹⁹ *Shih p.sh. F01237, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të F00328-ës, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. Shih gjithashtu*

IV. DISKUTIM

13. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykues konstatoi se deklaratat ishin dokumente në çfarëdo formë të asaj që ka thënë dëshmitari lidhur me faktet dhe rrethanat relevante të çështjes gjyqësore, dhënë në kontekstin e një hetimi ose procesi penal.²⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues u bind se deklaratat përfshiheshin në përkufizimin e 'deklaratës me shkrim' në bazë të kornizës ligjore të DHS-së që ka zbatuar vazhdimisht Trupi Gjykues.²¹ Gjithashtu, Trupi Gjykues konstatoi se deklaratat janë relevante *prima facie*, autentike, dhe kanë vlerë provuese *prima facie* e cila nuk zhbëhet prej efektit të tyre dëmtues.²² Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstatoi se deklaratat ishin të pranueshme si prova në pajtim me rregullat 138(1) dhe 143(2)(c).²³

A. PIKA E PARË

14. Mbrojtja kundërshton konstatimin e Trupit Gjykues se përkufizimi i 'deklaratës' përfshin deklaratën e vitit 2006, kur parashtrohet se bëhet fjalë për një dokument analitik, i cili nuk ka datë, nënshkrim, është shkruar nga një hetues, dhe pretendon të analizojë një a më shumë diskutime të mëparshme me një person emri i të cilit nuk jepet po që duhet të jetë dëshmitari.²⁴ Gjithashtu, Mbrojtja

F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

²⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 10, që i referohet Vendimit F02130, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Përdorimin e Deklaratave Të Mëhershme Mospërputhëse sipas Rregullës 143(2)*, 15 shkurt 2024, para. 15. Shih gjithashtu F01963, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Pranimin e Dokumenteve të Treguara W04769-ës*, 27 nëntor 2023, para. 15, poshtëshënimi. 35; F01852, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Pranimin e Dokumentit Shtesë në Lidhje me W02153-shin*, 11 tetor 2023, para. 8; F01380, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Dymbëdhjetë Dëshmitarëve të Parë të ZPS-së sipas Rregullës 154*, 16 mars 2023, konfidencial, para. 12, 26 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 7 nëntor 2023, F01380/RED); KSC-BC-2020-07, F00334, Trupi Gjykues, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 29 shtator 2021, para. 84-87.

²¹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 10.

²² Vendimi i Kundërshtuar, para. 11-16.

²³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 17.

²⁴ Kërkesa, para. 7-11.

pretendon se deklarata e vitit 2006 është problematike sa i përket autenticitetit dhe mbështetshmërisë.²⁵ Mbrojtja argumenton se përkufizimi i 'deklaratës' dhe pranueshmëria si provë e një deklarate të mëhershme mospërputhëse për vërtetësinë e përmbajtjes së saj në pajtim me rregullën 143(2) cenon në mënyrë të pashmangshme drejtësinë e procesit, parimin e dëshmive gojore dhe mundësinë e Mbrojtjes për kundërshtimin e provave, si dhe rezultatin e gjykimit.²⁶ Mbrojtja parashtrohet po ashtu se vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Pikën e Parë do të kontribuonte thelbësisht në procesin gjyqësor duke dhënë garanci ligjore për interpretimin e rregullave lidhur me pranimin e provave dokumentare.²⁷

15. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Parë ka të bëjë me themelësinë e Vendimit të Kundërshtuar dhe, për këtë arsye, del jashtë kuadrit të kriterëve të lejes për apel.²⁸ ZPS-ja argumenton se Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me konstatimin e Trupit Gjyqësor se deklarata e vitit 2006 përbën deklaratë sipas kornizës ligjore të DHS-së.²⁹ ZPS-ja pretendon se argumentet e Mbrojtjes lidhur me autenticitetin, mbështetshmërinë dhe vlerën provuese të deklaratës së vitit 2006 nuk kanë të bëjnë me cilësimin e saj si deklaratë.³⁰

16. Siç është përmendur më lart, në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjyqësor konstatoi se Deklaratat përfshiheshin në përkufizimin e 'deklaratës' sipas kornizës ligjore të DHS-së pasi përbënin dokumente në çfarëdo formë të asaj që ka thënë Dëshmitari lidhur me faktet dhe rrethanat relevante të çështjes gjyqësore, dhënë në kontekstin e një hetimi ose procesi penal.³¹ Për këtë konstatim, Trupi Gjyqësor shfrytëzoi dhe zbatoi përkufizimin e 'deklaratës' në përputhje me jurisprudencën e pranuar.³² Gjithashtu, Trupi Gjyqësor konstatoi se deklaratat, përfshirë

²⁵ Kërkesa, para. 11.

²⁶ Kërkesa, para. 12-13.

²⁷ Kërkesa, para. 14.

²⁸ Përgjigja, para. 4.

²⁹ Përgjigja, para. 4.

³⁰ Përgjigja, para. 4.

³¹ *Shih më lart* para. 13.

³² *Shih më lart* poshtëshënimin. 20.

deklaratën e vitit 2006, ishin relevante *prima facie*, autentike, provuese, dhe jodëmtuese, dhe nënvizoi se do të mbante parasysh faktorë të tillë si për shembull pasaktësinë e pretenduar e deklaratave gjatë vlerësimit të peshës që do t'u jepej deklaratave në kuadrin e tërësisë së provave.³³ Mbrojtja nuk arrin të shpjegojë për çfarë arsye duhej të kishte zbatuar standard të ndryshëm Trupi Gjykses ose në çfarë mënyre është i gabuar standardi në fjalë. Në veçanti, Trupi Gjykses nuk mund të pajtohet se duhet zbatuar një përkufizim i ndryshëm i nocionit të 'deklaratës' sipas rregullës 143(2) nga ai sipas rregullave 153-155. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Parë përbën thjesht mospajtim me zbatimin nga ana e Trupit Gjykses të përkufizimit të 'deklaratës' për deklaratën e vitit 2006, dhe përfundimisht edhe me pranimin e saj si provë.³⁴ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të provojë se Pika e Parë përbën aspekt që buron nga Vendimi i Apeluar.

17. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me Pikën e Parë. Për pasojë, hidhet poshtë kërkesa për miratimin e lejes për apel për Pikën e Parë.

B. PIKA E DYTË

18. Mbrojtja pretendon se Trupi Gjykses gaboi në përcaktimin e drejtpeshimit midis vlerës provuese të deklaratës së vitit 2006 dhe efektit të pretenduar dëmtues të saj.³⁵ Në veçanti, Mbrojtja parashtrohet se Vendimi i Kundërshtuar: (i) nuk mori parasysh vlerën e ulët provuese të deklaratës së vitit 2006;³⁶ (ii) nuk mori parasysh dëmin ndaj Mbrojtjes;³⁷ dhe (iii) nuk vlerësoi nëse dëmi ishte më i madh se vlera

³³ *Shih më lart* para. 13. *Shih gjithashtu* Vendimin e Kundërshtuar, para. 14.

³⁴ *Contra* Kërkesa, para. 11.

³⁵ Kërkesa, para. 16.

³⁶ Kërkesa, para. 16(i).

³⁷ Kërkesa, para. 16(ii).

provuese.³⁸ Mbrojtja argumenton edhe se aspektet që kanë të bëjnë me vlerësimin e dëmit, nga vetë natyra e tyre, ndikojnë në drejtësinë e procesit dhe në rezultatin e gjykimit.³⁹ Gjithashtu, Mbrojtja parashtrohet se vendimi i menjëhershëm i Gjykatës së Apelit mbi Pikën e Dytë do të kontribuonte thelbësisht në procesin gjyqësor.⁴⁰

19. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja nuk ka arritur të provojë se Pika e Dytë është e apelueshme.⁴¹ ZPS-ja argumenton se Mbrojtja: (i) nuk merr parasysh se Trupi Gjyqësor e mori parasysh faktin se deklarata e vitit 2006 nuk pretendon të jetë dokumentim fjalë për fjalë apo i plotë; (ii) kishte mundësi reale për t'i bërë pyetje dëshmitarit; (iii) thjesht nuk pajtohet me vlerësimin e Trupit Gjyqësor; dhe (iv) shtrembëron arsyetimin e Trupit Gjyqësor se efekti dëmtues i deklaratës së vitit 2006 nuk zhbën vlerën e saj provuese.⁴²

20. Siç është përmendur më lart, në Vendimin e Apeluar, Trupi Gjyqësor konstatoi se deklaratat ishin relevante, autentike *prima facie*, dhe kishin vlerë provuese *prima facie*, e cila nuk zhbëhej prej efektit të tyre dëmtues.⁴³ Në veçanti, Trupi Gjyqësor konstatoi se: (i) dëshmitari dëshmoi në mënyrë të plotë mbi ngjarjet që tregohen në deklaratat e tij, përfshirë deklaratën e vitit 2006 dhe nuk mohoi se ai ishte autori i deklaratave; dhe (ii) Mbrojtja kishte mundësi të shumta për t'i bërë pyetje dëshmitarit lidhur me çdo aspekt të dëshmisë që e mendonte me vend, përfshirë saktësinë e deklaratave dhe mënyrën si ishin marrë.⁴⁴ Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor u bind se veçantia e pretenduar e deklaratave, përfshirë deklaratën e vitit 2006, si dhe pasaktësitë e pretenduara nuk pengonin pranimin e tyre si prova.⁴⁵ Gjithashtu, siç është përmendur më lart, Trupi Gjyqësor nënvizoi se këta faktorë do t'i merrte parasysh gjatë vlerësimit të peshës që do t'u jepej deklaratave në kuadrin e tërësisë

³⁸ Kërkesa, para. 16(iii).

³⁹ Kërkesa, para. 18-19.

⁴⁰ Kërkesa, para. 20.

⁴¹ Përgjigja, para. 5.

⁴² Përgjigja, para. 5.

⁴³ *Shih më lart* para. 13.

⁴⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 14.

⁴⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 14.

së provave.⁴⁶ Nga kjo rrjedh se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,⁴⁷ Trupi Gjykses e vlerësoi efektin dëmtues të pranimi të deklaratës së vitit 2006 kundrejt vlerës së saj provuese, sipas rregullës 138. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Dytë shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykses dhe thjesht përbën mospajtim me to.⁴⁸ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk arriti të vërtetonte se Pika e Dytë është aspekt që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

21. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me Pikën e Dytë. Për pasojë, hidhet poshtë kërkesa për miratimin e lejes për apel për Pikën e Dytë.

C. PIKA E TRETË

22. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk kërkoi leje për ta pyetur dëshmitarin lidhur me deklaratën e vitit 2018 si deklaratë mospërputhëse, dhe se dëshmitari u pyet për këtë dokument për t'i rifreskuar kujtesën në pajtim me rregullën 143(1) dhe jo në kuadrin e një deklarate mospërputhëse në pajtim me rregullën 143(2)(c).⁴⁹ Mbrojtja kundërshton faktin që një dokument i cili përdoret për rifreskimin e kujtesës së dëshmitarit të mund të pranohet më pas si provë materiale përmes rregullës 143(2)(c).⁵⁰ Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se: (i) rrethanat në të cilat mund të përdoret apo pranohet si provë një deklaratë e mëhershme ndikojnë në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;⁵¹ dhe (ii) udhëzimi detyrues i Gjykatës

⁴⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 14. *Shih gjithashtu më lart para. 16.*

⁴⁷ Kërkesa, para. 16.

⁴⁸ *Contra* Kërkesa, para. 17.

⁴⁹ Kërkesa, para. 21.

⁵⁰ Kërkesa, para. 21.

⁵¹ Kërkesa, para. 23.

së Apelit lidhur me interpretimin e rregullës 143 do të kontribuonte thelbësisht në procesin gjyqësor.⁵²

23. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Tretë: (i) nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar; dhe (ii) shtrembëron kornizën ligjore të DHS-së.⁵³ Në veçanti, ZPS-ja argumenton se Mbrojtja shtrembëron kuptimin e 'deklaratës së mëhershme mospërputhëse' sipas rregullës 143(2)(c).⁵⁴ ZPS-ja parashtrohet se, megjithëse nuk bëri me dije zyrtarisht se synonte t'ia tregonte dëshmitarit deklaratën e vitit 2018 për t'i rifreskuar kujtesën, ZPS-ja bëri të qartë gjatë pyetjeve për dëshmitarin se deklaratat e mëhershme do të përdorëshin për të shqyrtuar mospërputhjet, përveçse në qoftë se përcaktohej ndryshe.⁵⁵

24. Siç është përmendur më lart, në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se deklaratat ishin të pranueshme sipas rregullave 138(1) dhe 143(2)(c).⁵⁶ Në veçanti, Trupi Gjykses vuri në dukje se deklaratat, përfshirë deklaratën e vitit 2018, u përdorën gjerësisht nga ZPS-ja dhe Mbrojtja e Selimit gjatë pyetjeve për dëshmitarin, ndër të tjera, për ta ballafaquar atë me ato që thuhej se ishin mospërputhje dhe ndryshime në mënyrën e përshkrimit të disa rrethanave.⁵⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses u bind se tri deklaratat, përfshirë deklaratën e vitit 2018, mbuloheshin nga rregulla 143(2)(c) dhe ishin relevante lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në provat e tij.⁵⁸ Rregulla 143(2)(c) përmend vetëm "nëse dëshmitari ka dhënë në çfarëdo kohe një deklaratë të mëhershme mospërputhëse". Kjo rregull nuk e kufizon kategorinë e deklaratave që mund të pranohen në pajtim me këtë rregull në ato që është provuar se janë mospërputhëse për shkak të ndonjë arsyeje, as nuk kufizohet në deklaratat e

⁵² Kërkesa, para. 24.

⁵³ Përgjigjja, para. 6.

⁵⁴ Përgjigjja, para. 6.

⁵⁵ Përgjigjja, para. 6.

⁵⁶ *Shih më lart* para. 13.

⁵⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 11, *që i referohet, ndër të tjera*, Transkriptit të Seancës, 29 gusht 2024, f. 19293-19296.

⁵⁸ Vendimi i Kundërshtuar, para. 11.

përdorura për të minuar besueshmërinë e dëshmitarit. Interpretimi i ngushtë i kësaj rregulle sipas Mbrojtjes nuk ka bazë në Rregullore. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se Pika e Tretë shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykses dhe thjesht përbën mospajtim me to.⁵⁹ Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk arriti të vërtetonte se Pika e Tretë është aspekt që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

25. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me Pikën e Tretë. Për pasojë, hidhet poshtë kërkesa për miratimin e lejes për apel për Pikën e Tretë.

V. KLASIFIKIMI

26. Trupi Gjykses vëren se Kërkesa është dorëzuar si konfidenciale. Trupi Gjykses e urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë një version të redaktuar publik ose të kërkojë riklasifikimin e Kërkesës deri **të premtën, 25 tetor 2024**.

VI. VENDIM

27. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **E RRËZON** Kërkesën; dhe
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë një version të redaktuar publik ose të kërkojë riklasifikimin e Kërkesës deri **të premtën, 25 tetor 2024**.

⁵⁹ *Contra* Kërkesa, para. 21.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 11 tetor 2024

Në Hagë, Holandë.